

VENDIM
Nr.139, datë 22.12.2008

**PËR NJË NDRYSHIM NË KONTRATËN E FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE
PËR KLIENTIN E KATEGORISË JOFAMILJARE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.41, DATË 31.8.2005, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 44, pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe neneve 7, 111, 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.12.2008, pasi shqyrtoi propozimin për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën e furnizimit me energji elektrike për klientin e kategorisë jofamiljare, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.41, datë 31.8.2005 dhe konstatoi nevojën për disa ndryshime në kontratën e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve jofamiljarë, duke qenë se paragrafi i fundit i pikës 8.1, germa “i” të kontratës së furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve jofamiljarë nuk plotëson më qëllimet e ligjit nr.9997, datë 22.9.2008 “Për disa ndryshime në ligjin “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar”, i cili nuk parashikon më vendosjen e masave administrative për mospërbushjen e detyrimeve që burojnë nga kontrata, sipas nenit 46/1 të këtij ligji

VENDOSI:

1. Në kontratën e furnizimit me energji elektrike për klientin e kategorisë jofamiljare, të miratuar me vendimin nr.41, datë 31.8.2005, bëhet ky ndryshim:

B) Në pikën 8.1, germa “i” paragrafi i fundit, ndryshon dhe bëhet si më poshtë:

Në këto raste furnizuesi vepron sipas legjislacionit në fuqi.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OSSH sh.a. dhe KESH sh.a. për këtë vendim.

3. Ngarkohet furnizuesi publik me pakicë (OSSH sh.a.) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta